



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 28.04.2025

Numër Protokoli: 3081/2025

A.nr.490/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.490/2025, të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesi S.B, kundër organit të punësimit: Komunës së Hanit të Elezit, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.490/2025, të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesi S.B.

II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi S.B (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 18.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit 02.Nr.207/2025 të datës 15.01.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Hanit të Elezi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 24.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Hanit të Elezi, ndërsa, kjo e fundit, më datë 27.03.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë, se bashku me provat materiale lidhur me çështjen në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi fillimisht sipas Aktit të Emërimit 02.Nr.8342/20212 të datës 13.11.2012, ka mbajtur pozitën Udhëheqës i Njesisë së Autoparkut në Komunën e Hanit të Elezit si nëpunës i shërbimit civil. Tutje, Komuna e Hanit të Elezi, bazuar në Ligjin Nr.03/L-212 të Punës, më datë 12.02.201 ka nënshkruar më ankuesin në cilësi punëdhënës punëmarrës Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër 02/1690/2015, për pozitën e njëjtë Udhëheqës i Njesisë së Autoparkut në Komunën e Hanit të Elezit. Me tej, në zbatim të dispozitave nenit 83 paragrafi 16 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (që ndërlidhet me deklarin e statusit të zyrtarit publikë), i aplikueshëm nga data 10.07.2020 deri më 26.09.2023, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Hanit të Elezit, më datë 15.02.2022 ka nxjerr Vendim 02nr.1120/2022, me të cilin pozitën e ankuesit Udhëheqës i Njesisë së Autoparkut, e ka deklaruar si nëpunës të shërbimit civil. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë (05.02.2023) sipas Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve, Komuna e Hanit të Elezit pozitën e ankuesit e ka propozuar si drejtues të ulët me koeficient të pagës 7.18, mirëpo Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Thesari më datë 01.06.2023, pozitën e ankuesit e ka klasifikuar në kategorinë e Nëpunësit teknik dhe mbështetës me klasë GJ49 dhe koeficient 3.96.

Tutje sipas provave materiale të çështjes del se më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë(datë 2509.2023) Komuna e Hanit të Elezi në mbështetje të nenit 95, 96, 97 paragrafi 1 të këtij ligji, nenit 10 dhe 11 të Ligjit të Punës dhe nenit 20 paragrafi 2 të Rregullores 05/022 për Procedurat Konkurruese për Pranim për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, më datë 18.09.2024, ankuesit i ka lëshuar Kontrata Punë për Kohë të Pacaktuar me Nr. 7825/2024, për pozitën Udhëheqës i Njesisë së Autoparkut, me kategori Nëpunës Teknik dhe Mbështetës (Udhëheqës), të cilën kontratë e ka nënshkruar edhe ankuesi, ndërsa më datë 15.01.2025 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Hanit të Elezit, ka nxjerr Vendim 02.Nr.207/2025, me të cilin ka bërë shfuqizimin e Vendimit 02nr.1120/2022 të datës 15.02.2022 për deklarin e statusit të nëpunësit duke e lënë në fuqi Kontratën e Punës për Kohë të Pacaktuar me Nr. 7825/2024 të datës 18.09.2024.

Ankuesi, në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ndryshimi i statusit nga nëpunës civil në atë teknik dhe mbështetës, është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe panjë procedurë të qartë dhe transparente dhe në kundërshtim të plotë me standardet ligjore. Kërkon të shfuqizohet vendimi i kundërshtuar me ankesë, të rikthehet në statusin e mëparshëm si nëpunës i shërbimit civil.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike administrative, konstaton se ankuesi fillimisht marrëdhënien e punës e ka themeluar si shërbyes civil kjo dëshmohet edhe sipas akt emërimit 02.Nr.8342/20212 të datës 13.11.2012, i cili është lëshuar në kuptim të dispozitat të nenit 96 dhe 97 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo më datë 08.12.2014, Ministria e Administratës Publike me qëllim të sqarimit të paragrafit 4 të nënti 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka lëshuar Qarkoren Administrative Nr. 01/2014, me të cilën lidhur me funksionet dhe titujt e vendeve të punës që kryejnë funksione mbështetëse dhe të mirëmbajtës, e për rrjedhojë sipas pikë 4, tek Funkcioni-Shërbimi Transport, Zyrtar i Autoparkut nuk është trajtuar si

shërbyes civil, dhe mbi këtë bazë edhe ankuesit i është lëshuar Kontratën e Punës për Kohë të Pacaktuar me numër 02/1690/2015 e datës 12.02.2015 sipas Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit thekson faktin së me hyrën në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (i cili ka qenë i aplikueshëm nga data 09.07.2020 deri më datë 26.09.2023), gjegjësisht sipas nenit 83 dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, institucionet kanë qenë të obliguar të bëjnë deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë, e mbi këtë bazë Komuna e Hanit të Elezit respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore përmes Vendimit 02nr.1120/2022 të datës 15.02.2022, ka bërë deklarimin e statusit të pozitës së ankuesit duke e klasifikuar në kategorinë e nëpunës të shërbimit civil, mirëpo, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (i zbatueshëm nga data 26.09.2023), gjegjësisht sipas nenit 102 paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar: 1. *Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t'ju ofrojnë zyrtarëve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës.* 2. *Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik,* e një rrjedhën e këtij përcaktimi ligjor Komuna e Hanit të Elezit ka lidh me ankuesin Kontratë Punë për Kohë të Pacaktuar (Nr. 7825/2024 të datës 18.09.2024) ashtu që pozitën e ankuesit e ka kategorizuar në kategorinë Nëpunës Teknik dhe Mbështetës (Udhëheqës), e të cilën kontratë e ka nënshkruar edhe vet pala ankuese, pa asnjë vërejtje.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si me sipër, e duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *Kategoritë e zyrtarëve/publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit.* 2. *Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim.* Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. 5. ***Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike***” Kolegji erdhi në përfundim së ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, kështu që duke u bazuar në Nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj, duke qenë së ankuesi ka statusin e nëpunësit teknik dhe mbështetës, atëherë Këshilli nuk ka kompetencë lëndore për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 18.03.2025.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 27 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78

dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson faktin së nëpunësi teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Pas konstatimit se Këshilli nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.490/2025 dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike të brendshme pranë organit publik punëdhënës, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 88 të Ligjit Nr.08/L-196 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me këtë çështje juridike-administrative duke e udhëzuar të njëjtën për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente, pasi që lënda nuk mund të bartet të gjykata kompetente ngase

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.490/2025

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.B;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.